

## Ndihmoni Syrin e Kaltër

Çfarë ka ndodhur me Syrin e Kaltër? Shumë veta e bëjnë këtë pyetje, por nuk gjejnë ndonjë përgjigje shkencore dhe zyrtare, sepse shteti nuk bëri kurrë një studim për të zbuluar shkaqet e zhdukjes dhe rillindjes së tij. Natyrisht që Ministria e Mjedisit ka probleme mjedisore më të mëdha se Syri i Kaltër, edhe Ministria e turizmit ka plot zona të tjera turistike me probleme. Por për publikun e gjerë, vdekja e Syrit të Kaltër ishte goditja më e madhe e bukurisë natyrore shqiptare, që u shoqërua me një dhimbje të gjithanshme nga të gjithë: "Sa keq! Ishte një mrekulli e natyrës sonë. Po shteti përse s'vë dorë?". Po shteti ka probleme më të mëdha dhe nuk e di se ç'po ndodh me Syrin e Kaltër.

Shumë informacione mbi të, shpërndahen nga vizitorët e shumtë të kësaj zone: "Ishte te Syri i Kaltër dhe pashe se kish filluar të dilte përsëri ujë por jo aq sa më parë", "Syri i Kaltër ishte ringjallur. Si ndodhi"? Edhe vetë përfaqësues të shtetit shpesh pyesin: "More, si është gjendja e Syrit të Kaltër?". Dhe ata e duan këtë mrekulli të natyrës sonë. Bile kur takojnë ndonjë të huaj apo kur janë jashtë shtetit krenohen me të: "O, ne kemi një burim me ujë të kulluar që është sa një lumë dhe del nga fundi i tokës... Është i rrallë në Evropë. Po të vini në Shqipëri duhet ta shikoni". Në fillim të shekullit të kaluar, Konica thoshte se shqiptarët kanë një natyrë shumë të bukur por nuk e respektojnë të bukurën. Është e vërtetë që për t'u përkujdesur për Syrin e Kaltër duhen lekë dhe lekët është më mirë për t'i përdorur në fusha më të rëndësishme, si p.sh: për të dalë ministri në IV dhe të tregojë se sa shumë ka punuar Ministria e Mjedisit për mbrojtjen e natyrës. Kështu që, kur Syri i Kaltër ishte në prag të vdekjes, s'u gjat asnjë lek për ta ndihmuar, ndonjë faji ishte i saj, që lejoi të priteshin penët sipër zonës, që i dha lejen mjedisore një lokali mu sipër burimeve, i cili u bë shkak për devijimin e pëmbytjes dhe mbushjes së burimit me zhavorr. As Ministria e Turizmit nuk ndihmoi, ndonjë e ka shfrytëzuar aq shumë në guidat dhe në programet e turistëve. Vetëm disa zhytës të shoqatës "Nënujsat" e vizituan atë me shpenzimet e tyre dhe zbuluan shkaqet e sëmundjes së saj. Shteti pranoi se do japë para për ta kulluar, por shteti s'haqshon para për gjëra kaq të vogla. Por ja një Fondacion tha: "Më kanë ngjellur mua disa lekë këtë vit. A mund të bëni ndonjë gjë për Syrin e Kaltër"? Kështu shoqata "Nënujsat" e studioi burimin deri në thellësinë 45 m ku u zbuluan zhavorr, gurë dhe tulla të ardhura nga pemri dhe lokali që është ndërtuar mbi të. Por z.Sherif Bundo që i ka dhënë lejen këtij ndërtimi ka menduar të zhvillojë ekonominë në kurriz të Syrit të Kaltër. Zhytësit e shoqatës "Nënujsat" i sistemon skarpitet e Syrit, sollën dhe binë jeshile nënujore dhe i vendosen përreth "retinës" së tij nën ujë, për t'i rikthyer formën tipike të syrit, pastuan "qepallat" e syrit të mbuluar nga zhavorret e ardhura nga vërshimi i lumit. Syri i Kaltër u rikthye në syrin e bukur të dikurshëm. Por rreziku përreth tij nuk u hoq dot, se kërkonte shumë para. Pas (Vijnë në faqen 4)

## 5 qershori-Dita Ndërkombëtare e Mjedisit ende s'është kombëtare

Në këtë ditë, në vitin 1972, në Suedi u mbajt Konferenca e Stokholmit për Mjedisin Njerëzor. Në të u mbledhën përfaqësues nga e gjithë bota dhe shprehën shqetësimet e tyre për rritjen e problemeve mjedisore.



Krahasoni nëpërmjet fotove se sa është zvogëluar Syri i Kaltër për shkak të rrëshqitjes së zhavorreve përreth. (Rrapit i kanë dalë rrenjtët.)



## "Jeto Gjelbër" në Tiranë

Lëvizja "MUAFT!" organizoi më 5 qershor, në hotel "Tirana International" një debat për problemet mjedisore në Tiranë.

Z. Veliaj theksoi se mjedisi nuk zë vend kryesor në axhendat e politikanëve dhe të mediave, prandaj dhe veprimtaria e sotme do të zëzë vend diku në faqet e fundit të gazetave apo në fund të ndonjë edicioni lajresh...

Lexo fq. 2



## Kopshti zoologjik: Ta ringjallim, për ta jetuar!



Qendra "EDEN" dhe vullnetarët e saj organizojnë një fushatë për të promovuar dhe rikonstruktuar Kopshtin Zoologjik të Tiranës. Finalizimi i kësaj fushate ishte koncerti tek anfiteatri që kishte si synim ngritjen e fondeve për të realizuar ringjalljen e kopshti.

Lexo fq. 2

## Tirana dhe përbindëshi që rritet në beton

Tirana, nga 9m2/banor sipërfaqe të gjelbra, që ka pasur para vitit 1990, tani ka 2,8m2/banor, çka duhet të alarmonte organet manaxhuuese, kur dihet se edhe norma minimale e sanksionuar me ligj në rregulloren urbanistike për përpilimin e planeve rregulluese është pranuar 7m2/banor.

Lexo fq. 4



## Konica- pararendësi i ambientalizmit



Për nga spektri enciklopedik, mendja e tij i ngjan një diamanti të madh me shumë prizma apo faqe. Në një nga këto faqe shkelqen plot ngjyra të gjalla natyra shqiptare me visaret e saj të rralla...

Lexo fq. 6

## Zonat e mbrojtura rrezikojnë të shkatërrohen

-Investimet shtetërore ose mungojnë, ose janë të panjaftueshme për mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura

-Në çdo zonë të mbrojtur janë ngritur administrata, të cilat përbëjnë atë që quhet njësisia e zbatimit të problemeve që dalin, por ende frytshmëria e tyre lë për të dëshinuar

Lexo fq. 3

## Edhe njëherë për ndotjen urbane...

-Vazhdon të rritet pa ndërprerje rreziku nga ndotja urbane, sidomos në qytetet e mëdha dhe në zonat bregdetare



Lexo fq. 4

## Njoftim

Të dashur lexues e bashkëpunëtorë, Nisur nga strategjia jonë për të kaluar në një shkëmbim informues të qëndrueshëm për mjedisin, në bazë të orientimit të bordit të grupimit të shoqatave mjedisore "Ekolëvizja", redaksia ju fton për t'u pajtuar në gazetën "Ekolëvizja".

Pagosa e pajtimit për një vit kalendarik, me dy numra në çdo muaj, është vetëm 1000 (një mijë) lekë. Rëndësitja e kësaj së pajtimit bëhet menjëherë pas derdhjes së shumës dhe fillimit të marrjes së gazetës.

Nëse jeni i interesuar të vazhdoni të merrni gazetën "Ekolëvizja", drejtohuni në redaksinë tonë për pagesën dhe për probleme të tjera me interes të përbashkët.

Adresa: rruga "Avdyll Frashëri", ish-klinika e udhëngjas, shkalla 3, qafa 4, Tiranë.

Tel. 04 234 851

Cell. 068 21 82 081;

e-mail: [ekolevizja@yahoo.com](mailto:ekolevizja@yahoo.com)  
Redaksia e gazetës "Ekolëvizja"



Me moton "Kopshti zoologjik: Ta ringjallim për ta jetuar!", - u zhvillua një koncert festiv më 12 qershor tek amfiteatri, në kodrat e liqenit artificial të Tiranës. Në të interpretuan këngëtarë të njohur të muzikës së lehtë shqiptare, artistë të cirkut të Tiranës, si dhe disa grupe balerinësh nga Qendra Kulturore e Fëmijëve. Koncerti u organizua nga qendra "EDEN", e cila moton e sivjetshme të Ditës Botërore të Mjedisit e përqendroi për mosshkretëtirëzimin e kopshtit zoologjik të Tiranës, si dhe ringjalljen e tij, duke synuar në rigjenerimin e fondeve dhe të donacioneve.

## Kundër "ngujimit" të kafshëve

Ishte një veprimtari e thjeshtë e një natyre disi ndryshe në mbrojtje të kopshtit zoologjik. Megjithatë notin jo të qëndrueshëm në mjediset e amfiteatrit ishin të pranishëm mjaft shikues, të cilët u argëtuan nën shoqërinë e këngëtarëve të mirënjohur të muzikës shqiptare: Eneida Taifia, Emal Meraqi dhe Çiljeta Xhilaga. Emocione festive dhe argëtuese përcollën gjithashtu edhe artistët e talentuar nga cirku i Tiranës, si dhe balerinët nga qendra kulturore e fëmijëve.

prezantueses së koncertit, Jonida Meraqi, këngëtarëve, balerinëve dhe artistëve të cirkut.

Edhe ndërtimi i skenës u përshtat tërësisht me përmbajtjen e një veprimtarie të tillë. Nëpërmjet saj u përcollën gjithashtu tek të pranishmit mesazhet për mosshkretëtirëzimin e të vetmit kopsht zoologjik në Shqipëri. Pankartat me sloganet përkatese përmbanin mesazhe, të cilat mund të perceptoheshin shumë thjeshtë nga qytetarët. Në fund të skenës ishte improvizuar edhe një

E pra, kjo është në të vërtetë gjendja e kafshëve në kopshtin tonë zoologjik, kopsht të cilin "ja dashje" të gjithë e kemi lënë në nëshirë të fatit. Kur fare mirë ai mund të shërbente si "një kabinet i gjallë" i botës shtazore sidomos për fëmijët. Jo më kot prindërit kur u tregojnë fëmijëve për mallra, marrin libra me ilustrime për t'u treguar atyre kafshët. A nuk do ishte në mirë sikur fëmijët t'i shihnin ato në të vërtetë, të luajnë me to, t'i ushqejn dhe t'u japin dashuri?!

Fëmijët nuk kanë nevojë vetëm të leshojnë kafshët shtëpiake, për të cilat kujdesi dhe dashuria është maksimale, por ata kanë nevojë edhe për kafshë të tjera, për t'u njohur me shprehje natyren për t'i dhënë dhe për të marrë dashuri prej saj.

Pra, të dashur prindër, qytetarë, qeveritarë, biznesmenë, individë që e doni natyrën; të gjithë ne, le të kujdesemi për kafshët e kopshtit zoologjik, ashtu siç kujdesemi për kafshët që kemi nëpër shtëpitë, makinat dhe zyrat tona. Duke dhënë ndihmesë të gjithë sipas mundësive tona do të mund të përmirësojmë kushtet në të cilat jetojnë kafshët e kopshtit zoologjik; do t'iu mundësojmë atyre "një shtëpi" të përshtatshme, të qetë, të pastër dhe të vizitueshme për ne e fëmijët.

Nëoshta edhe kjo veprimtari ka dhënë një ndihmesë për të ftuar të gjithë dashamirësit e natyrës.

T'i bashkohemi nismës që ka filluar qendra "EDEN" dhe të ndihmojmë të gjithë së bashku, që fëmijët tanë të mos dëgjojnë për kopshtin zoologjik vetëm në përallla.



Mënyra e organizimit, ndikoi që ky koncert shërbeu si një mënyrë me vlerë për të përcjellë emocione, momente festive dhe argëtuese tek shikuesit, por në të njëjtën kohë përdori gjithashtu edhe mesazhe të ndryshme. Kjo ndodhi përgjatë gjithë programit, ku tek të gjithë të pranishmit u përcollën mesazhet për ringjalljen dhe përmirësimin e kushteve të kopshtit zoologjik. Thirrjeve të drejtoreshës ekzekutive të qendrës "EDEN", znj. Merita Mansaku dhe drejtoreshës pranë zyrës së projekteve, Bashkia e Tiranës, znj. Doklea Shtylla, iu shtuan mesazhet e

minikopsht zoologjik, me disa të rinj, të cilët nbanin veshur maskat e disa kafshëve. Kuptimplotë është një fakt i thjeshtë. Nga kurioziteti një vajzë e vogël e pyeti nënën e vet: "Mami, pse janë ata njerëzit atje, për të ra këpër për të qeshur?". Përgjigjja e nënës ishte: "Jo, spirti i nanit, ata janë të rinj që imitojnë kafshët e kopshtit zoologjik, të cilat jetojnë në kushte shumë të këqija, pa ushqim, në "binuca të vogla" dhe të frikësura". Me këtë shprehim mund të pëmbledhim edhe vlerën e kësaj veprimtarie që patjetër do të ndikojë për një punë në të kujdeshme në kopshtin zoologjik të Tiranës.

## Deklarim me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit

- Aleanca qytetare për mbrojtjen dhe zhvillimin e gjirit të Vlorës proteston në Ditën Botërore të Mjedisit

Në Ditën Botërore të Mjedisit, aleanca qytetare për mbrojtjen dhe zhvillimin e gjirit të Vlorës protestoi ndaj klasës politike shqiptare për papërgjegjshmërinë e saj në gatishmërinë për të nënshkruar ndërtimin e veprave me bazë nafte në gjirin e Vlorës. Në protestë u thksua se me një veprim të tillë politikantët tanë u bëjnë një shërbim të madh fitimprurës multinacionaleve të naftës, që janë shkaktarët më të mëdhenj të ngrohjes globale dhe njëherazi kërcënuesit për një katastrofë ekologjike në këtë gjiri, i cili përmban në vetvete vlera të veçanta nga pikëpamja e ekosistemit (pohuaj i gjithi nën statusin e zonës së

mbrojtur), si dhe me vlera të jashtëzakonshme socialkulturore, që nuk e pranon një industri që mezikon jetën dhe të ardhmen e banorëve të zonës.

Por qeveria shqiptare, në kohën e sotme kur nuk ndërtohen me TEC-e me bazë nafte, vazhdon të shprehë pro ndërtimit të një TEC-i (në fakt janë tri të tilla në Vlorë), pikërisht në njërin nga zonat më të bukura të këtij ekosistemi, në kufi me zonën e mbrojtur të lagunës së Nartës, buzë detit me peizazhin më piktoresk, ku bashkohen gadishulli i Zërnecit, ishulli i Sazanit dhe gadishulli i Karaburunit, mbi rrënojat e qytetit të lashtë të Aulonës e të Triportit antik.

Pikërisht në këtë ditë të shënuar të mjedisit klasa politike shqiptare (përmendim këtu iniciativën e papërgjegjshme të grupit parlamentar të Partisë Socialiste për të mbështetur AMBO-n në parlament) pritej të miratonte, si për ironi, një rezolutë për ndërtimin e terminalit të raftësjetillës AMBO, i cili do të ngarkojë e do të shkaktojë një milion fuqi në ditë.

Nënsa AQMGJ-ja në këtë ditë shprehu edhe njëherë vendosmërinë se jo vetëm do të vazhdojë të protestojë, por do ta përshkallëzojë veprimtarinë e saj në detyrim të institucioneve shtetërore të respektojnë vullnetin e qytetarëve, sa kohë vetë shteti vazhdon të dhunojë hapur të drejtën për vendimmarrje të komunitetit sipas ligjeve në fuqi.

## Konferencë për mbrojtjen e zonës bregdetare të Mesdheut

Në Durrës nga 1-3 qershor u zhvillua konferenca ndër-kombëtare për mbrojtjen e Detit Mesdhe. Në të morën pjesë përfaqësues nga dikasteret e mjedisit të 20 vendeve mesdhetare, përfshi këtu edhe përfaqësues të Bashkimit

Evropian, nga programi i Kombeve të Bashkuara për mjedisin (UNEP), si dhe përfaqësues nga vende dhe organizma donatore për mjedisin.

Konferenca synoi të merete në shqyrtim planin e veprimtari të mbrojtjes së zonës bregdetare

nga ndotja, si dhe të shikojë mundësinë e mbështetjes për implementimin e tij në qeshitje që lichen me trajtimin e ujërave të zeza që shkaktohen në det, rehabilitimin e zonave historikisht të ndotura, menaxhimin e mbetjeve urbane etj.

O. Shoshi

## Erion Veliaj: "Pastërtia nuk është shkencë"

Në fjalën e tij z. Erion Veliaj thksoi se në fillim të viteve '90 shqiptarët filluan në mënyrë kolektive të rregullojnë banjat brenda shtëpive të tyre, pastaj filluan të rregullojnë dhomat e gjumit. Ndërkohë që ende nuk kanë dalë jashtë pragut të shtëpisë së tyre dhe nuk e konsiderojnë ende mjedisin si një pronë të përbashkët të cilën duhet ta ruajnë. Ne, shqiptarët, kemi shumë ndryshime me njëri-tjetrin: u përkasim disa besimeve të ndryshme fetare, votojmë për parti të ndryshme politike, jemi ca nga qytetet dhe ca nga fshatrat. Një nga gjërat që na bashkon dhe na lidh të gjithëve është se jetojmë në një mjedis të ndotur, nga më të ndoturit në rajon dhe në gjerë...

Në vazhdim të fjalës së tij z. Veliaj thksoi se mjedisi nuk zë vend kryesor në axhendat e politikanëve dhe të mediave, prandaj, - tha ai, - dhe veprimtaria e sotme, jam i sigurt se do të zë vend diku në faqet e fundit të gazetave apo në fund të ndonjë edicioni lajmesh.

Neve si qytetarë na kushton shumë pak të mos ndotim mjedisin dhe ta mbajmë pastër



## TIRANA, fundi i karvanit "Jeto gjelbër"

Lëvizja "MIAFT!" organizoi më 5 qershor, në hotel "Tirana International" një debat për problemet mjedisore në Tiranë, në kuadër të fushatës "Jeto gjelbër". Ishin të pranishëm zëvendësministri i Mjedisit Taulant Bino, shefi i kabinetit të kryetarit të Bashkisë, Eduard Salsi, përfaqësuesi i grupimit mjedisor "EkoLëvizja", Xhemal Mato, përfaqësues të agjencisë rajonale të mjedisit, analisti Ardiyan Klosi dhe të tjerë. Në debat morën pjesë edhe qytetarë të Tiranës, veprimtarë të lëvizjes "MIAFT!", si dhe ambasadori i Mretërisë së Bashkuar në Tiranë, z. Richard Jones.

Të pranishmit paraqitën gjatë këtij debati, që përkoi me Ditën Ndërkombëtare të Mjedisit, një situatë alarmante mjedisore në Tiranë. Z. Xhemal Mato i njohu të pranishmit me një studim të z. Agron Deliu, të kryer në emër të Institutit të Shëndetit Publik dhe të Institutit të Studimeve Ambientale, në bazë të të cilit del se në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë, shkakohen në ajër më jera tonë pluhur. Në këtë sasi pluhuri ka një përqendrim tepër të lartë të grimcave të imta (PM 10), grimca këto vëdekëpurëse. PM 10-ta vjan në masë të ndryshme nga shkarkimet e automjeteve dhe është veçanërisht karakteristik për makinat e vjetra me motor diesel. Nga monitorimi i cilësisë së ajrit, i kryer nga Ministria e Mjedisit, është konstatuar se mbi 90 për qind e popullatës urbane në qytetet kryesore dhe sidomos në Tiranë është e ekspozuar ndaj përqendrimeve vëdekëpurëse të grimcave PM 10. Automjetet shkaktojnë çdo vit në ajër 56,9 mijë tonë grimca të tilla që përmbajnë edhe elemente, si: SO2, NOx, CO etj. Shifra është skandaloze po ta krahasohet me të dhënat e vitit 1990, që ka qenë vetëm 1,3 mijë tonë! 86 për qind e automjeteve që qarkullojnë në Tiranë, përdorin diesel, ndërkohë që mëth 70 për qind e tyre janë prodhuar në vitet 1980-1989.

Zëvendësministri i Mjedisit, z. Taulant Bino thksoi se përveç shkakdimeve, që vijnë nga automjetet, elemente të tjera që ndotin ajrin në Tiranë, janë edhe ndërtimet që kryhen

pa respektuar rregullat mjedisore. "Ne kemi aktualisht një legjislacion të ri për këto probleme dhe do të na duhet të punojmë edhe më shumë në këtë drejtim", - tha ai.

Përfaqësuesi i Bashkisë së Tiranës, z. Salsi, nënvizoi se "Për fat të keq, ndonëse dëgjojmë shpesh të thuhet se mjedisi është prioriteti i qeverisë, në pas, sidomos në momentin e alokimit të fondeve nga buxheti, vërejmë se mjedisi nuk është aspak prioritet". Ai foli në tej për sipërfaqet e gjelbëruara në Tiranë dhe thksoi se ato janë situar ndjeshëm gjatë viteve të fundit, në krahasim me vitet para '90-të. Z. Salsi paraqiti para të pranishmëve një plan strategjik të hartuar nga Bashkia e Tiranës, në bazë të të cilit pënteti lokal do të zhvillojë të gjitha politikat mjedisore. Ai përmendi një tjetër problem tepër shqetësues për mjedisin, fushën e depozitimit të mbetjeve urbane në Sharrë.

Z. Ardiyan Klosi, u përqendrua kryesisht në situatën mjedisore në periferi të Tiranës. Ai solli shembuj konkretë sidomos për parkun në kodrat e Liqenit dhe për mungesën totale të një politike menaxhimi dhe mirëmbajtjeje të këtij parku. Në lidhje me mbetjet urbane, ai citoi mendimin e disa specialistëve, sipas të cilëve përbërja gjeologjike e zonës së Sharrës nuk është e përshtatshme për depozitimin e mbetjeve. Madje, sipas një studimi të kohëve të fundit, del se buzinat përreth kësaj zone janë tashtë të helmura, duke përbërë një mezik serioz për shëndetin e banorëve.

Ajo që tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve në këtë debat, ishte edhe mentaliteti dhe kultura qytetare e banorëve të Tiranës, kryeqytetit në të ndotur evropian.

Duke marrë pjesë në këtë debat, drejtuesi i lëvizjes "MIAFT!" Erion Veliaj, citoi një fragment nga vepra "Doktor Gjilpëra" e Konioës, ku tregohet çartë indiferenca dhe moskëqarja e shqiptarëve ndaj të bukurës.

Debati i mësipërm ishte i fundit ndër 10 debate të tjera të ngjashme që lëvizja "MIAFT!" ka organizuar gjatë majit në 10 qytete të ndryshme të vendit.



### A është edhe kombëtare Dita Ndërkombëtare e Mjedisit?

Edhe mjedisi ka një ditë të vetën, 5 qershorin-Dita Ndërkombëtare e Mjedisit, e cila kaloi pothuajse pa u ndier në vendin tonë. Për këtë mjafton t'u hedhim një vështrim të shpejtë titujve kryesorë të katër gazetave, ndër në të njohurat, të asaj dite:

"Shekulli": Berisha, asnjë ndryshim në qeveri...

"Korrieri": Ikje nga burgu me helikopter; ISI, Meta; Qeveria, vonesa të qëllimshme për zgjedhjet...

"Panorama": Alket Rizai arratiset nga burgu grek me helikopter...

"Koha jonë": Ekstradimi i Haxhiut rihap dosjen "Hajdari"....

Kurse në fakt veprimtaritë që u organizuan me 5 qershor, nuk munguan. Të tilla ishin: koncerti festiv i organizuar nga qendra "EDEN", që për shkak të motit u shty një javë më vonë; lëvizja "MJAFT!" bëri mbylljen e fushatës sensibilizuese "Jeto gjelbër" në hotel "Tirana Internacional", ku ishin të ftuar specialistë të ndryshëm të mjedisit; MPAU-ja (që thajse nuk e vlerësoi fare, me përjashtim të pranisë dhe të fjalës së zëvendësministrit në takim të lartpërmendur).

Nga dhjetëra gazetave të datës 5 qershor vetëm "Shekulli" ka një shkrim kushtuar Syrit të Kaltër, dhe ky ka një rastësor.

Të nesërmen më gjashtë qershor: "Panorama" pasqyron takimin e djeshëm të "MJAFT-it" në një të dhjetën e faqes me një foto të vogël dy me tre centimetra. "Shekulli" i kushtoi vend më të gjerë takimit me titullin alarmues: "Në tija e ajdrit, mëth 200 vdekje në vit në Elbasan"...

"Koha jonë", më tepër se simotrat e saj, i kushton mjedisit gjysmë faqe.

Në këto kushte kemi të drejtë të pyesim edhe një herë: A është një ditë e shënuar ndërkombëtare njëherit dhe kombëtare?

Ekovëzhguesi

# Zonat e mbrojtura rrezikojnë të shkatërrohen


-Investimet shtetërore ose mungojnë, ose janë të pamjaftueshme për mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura

-Në çdo zonë të mbrojtur janë ngritur administrata, të cilat përbëjnë atë që quhet njësi e zbatimit të problemeve që dalin, por ende frytshmëria e tyre lë për të dëshiruar

-Problem parësor për zonat e mbrojtura mbetet ndërgjegjësimi i komuniteteve për domosdoshmërinë e pjesëmarrjes aktive në mbrojtjen e mirëmbajtjen e tyre

Kohët e fundit Ministria e Mjedisit ka ndërmarrë disa masa për ruajtjen e zonave të mbrojtura në Shqipëri. Nuk ka kaluar shumë që nga koha kur është bërë një

hollësisht i dëntimit dhe në pas duhet vepruar. Ata pohojnë se mungesa e një veprimtarie të tillë ka qenë një ndër gabimet e bëra në ndërhyrjet e deritanismet.



ndërhyrje në zonën e Syrit të Kaltër, për restaurimin e tij, por duket se kjo ndërhyrje ka qenë e pamjaftueshme. Me gjithë masat e marra, kjo zonë turistike është dëmtuar sërisht.

Zona e Syrit të Kaltër është një sipërfaqe shumë e vogël, mëth 8,3 për qind e sipërfaqes që mbulojnë zonat e mbrojtura në Shqipëri (mëth 200 000 hektarë tokë gjithsej). Sipas specialistëve në Ministrinë e Mjedisit është e rëndësishme që para ndërhyrjeve konkrete jo vetëm në Syrin e Kaltër, por edhe në zona të tjera, si fillim duhet bërë një studim i

"Nuk mund të themi se s'ka interes për zonat e mbrojtura. Për dy-tre vjetësh në Syrin e Kaltër pati një dëmtim. Në atë kohë ka qenë Ministria e Rregullimit të Territorit që ngriti një grup punë. U bë edhe një investim nga ajo ministri për rregullimin e këtij dëmtimi. Me këtë ndërhyrje u pretendua se dëmtimi mori fund dhe u rregullua. Tani atje ka lindur një problem tjetër, por gjithsesi nuk mund të themi se nuk janë bërë ndërhyrje", - shprehet Zamir Dedej, specialist pranë Ministrisë së Mjedisit.

Në mbrojtje të zonave

turistike, për herë të parë qeveria ka ngritur një sektor që është vendosur në Ministrinë e Mjedisit. Burime nga kjo ministri bëjnë të ditur se në çdo zonë të mbrojtur janë ngritur administrata, të cilat përbëjnë atë që quhet njësi e zbatimit të problemeve në çdo zonë. "E gjitha kjo ka një vullnet politik për të krijuar strukturat në qendër", - shprehen specialistë të ministrisë. Ndërsa, për sa i përket buxhetit që vjen nga të ardhurat e zonave të mbrojtura, ky i fundit lryn në të ardhurat që ka ministria dhe pastaj investohet. Dhe vetëm një pjesë e vogël e këtij investimi shkon për zonat e mbrojtura. Këto investime kryesisht kanë të bëjnë me rregullime, mbjellje, sistemin e ujë. Veç tyre, në mbrojtje të këtyre zonave janë dhe disa projekte të huaja, të cilat vijnë në ndihmë për restaurimin e tyre. Specialisti z. Dedej tregon se këto projekte janë parashikuar të zbatohen në Butrint, Vlorë, Karavasta, Shkodër, Prespë etj. Sipas tij, disa nga këto projekte kanë filluar të zbatohen, siç është projekti për Vlorën, i cili ka gjashtë vjet që ka nisur zbatimin. Pritet që këtë vit ky projekt të jetë drejt përfundimit. Por, veç Vlorës, është miratuar dhe projekti i Prespës, i cili aktualisht është në procedurat e nënshkrimit të marrëveshjes.

(Vijon në faqen 5)

## KONTENIERË TË VEÇANTË PËR INERTET

-Bashkia e Tiranës vendos kontenierë të veçantë për hedhjen e mbeturinave inerte që krijohen nga vetë banorët

Duke parë volumin e madh të mbetjeve që krijojnë vetë banorët, Bashkia e Tiranës ka marrë masa për vendosjen në të gjitha rrugët e kryeqytetit kontenierë të veçantë për hedhjen e mbeturinave inerte që krijojnë nga vetë banorët. Ata janë të mëdhenj, deri në 5 metra kub volum dhe do të shërbejnë vetëm për këtë qëllim.

Sipas specialistëve të drejtorisë së pastrimit në Bashki, ata do të zbrazen vetëm një ditë të javës, duke ndikuar kështu edhe për vendosjen e rregullit. Njëkohësisht, për të gjithë ata banorë që hedhin në to mbeturina urbane, do të ketë penalizime. Specialistet shpjegojnë se pikërisht për këtë gjë, ata do të nisnin një fushatë sensibilizimi, sepse deri me tani kontenieret e vendosur janë zbrazur dy-tre herë në ditë për shkak se banorët i mbushin me mbetje urbane.

Gjithashtu, mësohet se këta kontenierë shërbejnë vetëm për mbetje inerte të krijuara nga familjarët, ndërsa për ato të firmave të ndërtimit do të shikohet mundësia e një zgjidhjeje tjetër. Specialistet thonë se aktualisht firmat e ndërtimit me mbetje inerte që krijojnë, mbushin gropën ose mundohen të gjejnë vetë vend se ku t'i hedhin, pasi e kanë të rëndësishme t'i çojnë edhe në Shpane. Ata shpjegojnë, se në fakt, për problemin e një vendi se ku mund të hedhin mbetje inerte firmat e ndërtimit, po studiohen një projekt edhe me zyrën e urbanistikës. "Nuk është e lehtë të caktohet një vend, pasi duhet gjetur vendi i përshtatshëm, duhen bërë shprehjet, duhen shumë para për ta bërë atë një pikë me parametrat e duhur".

# Ndërpriten punimet në rrugën e Tepelenës

Prej më tepër se një muaji punimet për rehabilitimin e rrugës së Tepelenës janë ndërprerë. Kjo për shkak se restaurimi i kësaj rruge rrezikon dëmtimin e një monumenti natyre (kryesisht në zonën e Ujit të Ftohtë). Ky i fundit përfshihet në zonat e mbrojtura dhe kësaj në bazë të ligjit nuk duhet prekur. Në momentin kur restaurimi i rrugës po i afrohej monumentit të natyrës, kanë nisur dhe reagimet e para për ndërprerjen e punimeve në mbrojtje të këtij monumenti. Veç Ministrisë së Mjedisit, reagimet kanë ardhur dhe nga agjencia rajonale e mjedisit, drejtoria e shërbimit pyjor të Tepelenës dhe Gjirëkastrës së bashku me inspektoratin në Tepelenë. Sipas zëvendësministrit të Ministrisë së

Mjedisit Taulant Bino kjo e fundit i është drejtuar me një letër Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për të bllokuar procesin e hapjes së rrugës së Tepelenës dhe për të vazhduar punimet në sektorë të tjerë. Por edhe pas masave të marra në mbrojtje të monumentit të natyrës, zëvendësministri thekson se rehabilitimi i rrugës do të vazhdojë pas studimit të situatës, pasi në këtë rast bëhet fjalë për një rrugë kombëtare, e cila është e një rëndësie të veçantë. Rehabilitimi i rrugës do të rifillojë, por duke mos shkatërruar peizazhin përreth saj, si: prerjen e parëve apo dëmtimin e burimeve ujore, çka përbën dhe pikën në të rëndësishme të këtij monumenti natyre.

- Ç'po ndodh aktualisht me këtë rrugë dhe çfarë është planifikuar nga specialistët e ministrive përkatëse?

- Deri tani janë kryer katër vizita nga specialistë të ministrisë, madje në dy vizitat e fundit kanë qenë të pranishëm edhe titullarë të ministrisë sonë, në krye të një grupi me specialistë tanë, të drejtorisë së shërbimit pyjor dhe të agjencisë rajonale të mjedisit. Në një pikë të dytë mbas marrjes së sugjerimeve paraprake nga ky grup pune është organizuar vizita nga vetë ministri i Mjedisit, ku u fol më në detaje dhe është anituar në një përfundim që të mos ketë dëmtime të tjera, por të ketë vetëm rehabilitim të rrugës.

- Cili është qëndrimi i qeverisë pas ndryshimit të planit fillestar?

- Për qeverinë kjo është një kosto e tepërt që s'ishte parashikuar fillimisht në atë rrugë, por ajo ka marrë përsipër që ta paguajë këtë kosto për të mbrojtur monumentet e natyrës nga ndërhyrja.

Intervistuan E. DURAJ - L. KOXHAJ



-Intervistë me zëvendësministrin e Ministrisë së Mjedisit, Taulant Bino lidhur me arsyen e ndërprerjes së punimeve në rrugën e Tepelenës dhe planet e parashikuara nga ministria për vazhdimin e mëtejshëm të rehabilitimit të kësaj rruge.

-A do të vazhdojnë punimet riparuese në rrugën e Tepelenës edhe pse ato rrezikojnë prishjen e një monumenti natyre?

- Në këtë rast kemi të bëjmë me një rehabilitim të rrugës ekzistuese dhe me këtë duhet të kuptojmë që ndryshimet nuk janë të mëdha. Njëkohësisht është edhe një monument natyre, por atje kalon dhe një rrugë që është rrugë kombëtare dhe qeveria e çdo shteti në këtë rast nuk do të lejonte që muga të shkatërrohej dhe pastaj të mos rehabilitohej se është një monument natyre. Monumenti i natyrës është në kategorinë e zonave të mbrojtura me një mbrojtje strikte, por kjo nuk do të thotë që muga nuk duhet të rehabilitohet.

- Ç'përbën planin fillestar

për rehabilitimin e rrugës?

-Që është fillimisht plani i rehabilitimit ishte shumë i zgjeruar. Por sipas ndërhyrjes që ishte parashikuar në fazën fillestare, rrezikohet monumenti i natyrës, duke shkaktuar prerjen e parëve, prishjen e peizazhit në disa pjesë dhe ndoshta me pasoja në burimet ujore që janë pikë në të rëndësishme e këtij monumenti.

- Cilat qenë strukturat shtetërore, që reagon fillimisht për mbrojtjen e monumentit të natyrës?

Kur merretimi i rrugës ishte duke u afruar monumentit të natyrës, reagoi fillimisht agjencia rajonale e mjedisit, pastaj drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor për të bllokuar procesin e

hapjes së rrugës pa marrë fare miratimin nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe në këtë pikë me iu kthyer kushteve të vendosura për lejen e mjedisit, ku citohet karakteri i monumentit të natyrës.

- Cilat janë masat konkrete që ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit dhe sa janë zbatuar ato?

-Në i jam drejtuar me letër Ministrisë së Punëve Publike, të Transportit dhe Telekomunikacionit për të ndërprerë punimet në këtë rrugë, duke i lënë numësinë kësaj ministrie për të vazhduar punimet në sektorë të tjerë. Gjithashtu, kemi kërkuar të rishikohen në detaje ndërhyrjet e bëra, në mënyrë që të shmanget impakti në këtë monument të natyrës.



# Edhe njëherë për ndotjen urbane...

- Vazhdon të rritet pa ndërprerje rreziku nga ndotja urbane, sidomos në qytetet e mëdha dhe në zonat bregdetare

Rritja e theksuar e sasisë dhe larmisë së artikujve të konsumit të përditshëm e të mallrave ushqimorë ka bërë që të rritet në mënyrë të theksuar edhe sasia e plehrave nga to, veçanërisht nga ambalazhet prej qelqi, lëndësh plastike, kartoni e metali. Për më tepër, mungon një sistem i përshtatshëm për grumbullimin

deri të moslargimi i plehrave nga mjediset ndërmjet blloqeve të banimit, duke përfshirë këtu edhe mbeturinat e ndërtimeve tashtë të shunëfishuara.

Gjithashtu në Shqipëri ende nuk është përfunduar një politikë e strategji për plehrat urbane, duke përfshirë këtu teknologjitë bashkëkohore për trajtimin dhe

përgjegjësisë dikasteret përkatëse dhe organet e pushtetit vendor, të cilat, ndonjëse janë deklaruar disa herë për zgjidhjen e problemit, janë ende shumë larg zotërimit të gjendjes.

Deri tani asnjë qytet në Shqipëri nuk e ka të zgjidhur plotësisht grumbullimin, transportimin dhe depozitimimin e mbeturinave urbane. E njëjta tablo është edhe për ujërat e zeza. Mungesa e plote e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza komunale në qytetet tona, si, për shembull: Tiranë, Durrës, Vlorë, Pogradec etj., ka nxjerrë probleme të mëdha të ndotjes së mjedisit e të rrezikimit të shëndetit të popullsisë, të cilat duhen trajtuar me përparësi, veçanërisht në zonat perspektive për zhvillimin e turizmit. Gjithashtu dëmtimet dhe çarjet në rrjetin e ujit të pijshëm, furnizimi me ndërprerje, rrjedhjet e ujërave të zeza, krijojnë një rrezik të vazhduar të infektimit të ujit të pijshëm nga ujërat e zeza për një pjesë të qyteteve. Ndërtimet e reja, veçanërisht në periferitë e qyteteve, nuk po shoqërohen me rrjetin e kanalizimeve të ujërave të zeza, dukuri që do të keqsojë në tëpër situatën mjedisore në zonat urbane.

depozitimeve të mbeturinave urbane janë terrere të papërshtatshme për këtë qëllim. Madje në shumë raste ato ndodhen edhe pranë shtretërve të lumenjve, duke ndotur në mënyrë të vazhdueshme ujërat e tyre dhe duke rrezikuar seriozisht cilësinë e ujërave nëntokësore, të cilat në së shunti janë burime të ujit të pijshëm.

Dëmtime të ndjeshme u janë shkaktuar edhe parqeve e lulishteve brenda dhe pranë qyteteve, për shkak të ndërtimeve të shkurta, në veçanti të bareve e kioskave, në kundërshtim flagrant me kriteret urbanistike e të natyres së mjedisit e peizazhit natyror. Sidomos tepër kritike është gjendja e krijuar në disa qytete kryesore ku po realizohen ndërtime relativisht të mëdha brenda sipërfaqeve të gjelbra, duke dëmtuar dhe duke pakësuar edhe më tej sipërfaqen e tyre.

Dukuria e ndertimeve të jashtëligjshme është i pranishëm edhe në mjaft rajone të tjera të vendit, sidomos në zonën bregdetare dhe më tepër në zonat ekologjikisht të mbrojtura ose me vlera të veçanta për zhvillimin e turizmit, si: Karavastaja, Golemi, Ksamili etj.



dhe transportin e plehrave, duke nisur që nga mungesat në kontejnerëve të plehrave, me dëmtimet ose zhdukjen e tyre e

riçarkullimin e tyre. Të gjitha këto mangësi kanë krijuar situata tepër shqetësuese në qendrat urbane, situata të cilat vënë përpara

Aktualisht shumica e vend-

Ornela SHOSHI

## Sipërfaqet pyjore sa vjen e po pakësohen

Pakësimi i sipërfaqeve pyjore dhe erozioni që ka përfshirë prej kohësh ekosistemin natyror të vendit është kthyer në një problem emergjent për mjedisin shoqëtar. Sipas të dhënave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), sipërfaqja pyjore e vendit tonë, që llogaritet në rreth 1 milion hektarë, po kërcënohet seriozisht nga erozioni, pasojë e shfrytëzimit pa kriter të kësaj pasurie. Kështu, përdorimi për përfitime vetjake dhe ndërtimet e shkurta pa leje dhe pa asnjë studim mjedisor kanë bërë që kurorat me pyje e drurë që rrethonin dikur Tiranën, të shkojnë vazhdimisht drejt zhdukjes. Në vijën bregdetare të Durrësit, rreth 40 kilometra, brezi pyjor po shkon dalëngadalë drejt zhdukjes, duke prerë qindra pisha. Dëmtime janë bërë në plazhin e Porto Romanos, të Currilave, Kepit të Lalzit etj., ku pothuaj po zhduken edhe gjumët e gjelbërimit pyjor. Problematike paraqitet gjendja edhe në sipërfaqen pyjore të Berati, ku zonat më të prekura paraqiten pyjet e: Tomorit, Borovës, Tëpanit etj.

Reduktimi i sipërfaqeve pyjore dhe degradimi i vazhdueshëm i tyre vjen jo vetëm si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të zonave pyjore, por edhe si pasojë e moskujdesit në mbrojtjen e tyre, treguar nga ana e autoriteteve lokale dhe atyre mjedisore, që qerojnë në vend.

Pjerin PAULINI

# Tirana dhe përbindëshi që rritet në beton

Tirana, nga 9m<sup>2</sup>/banor sipërfaqe të gjelbra, që ka pasur para vitit 1990, tani ka 2,8m<sup>2</sup>/banor, çka duhet të alarmonte organet manaxhuese, kur dihet se edhe norma minimale e sanksionuar me ligj në rregulloren urbanistike për përpilimin e planeve rregulluese është pranuar 7m<sup>2</sup>/banor.

## Peisazhi, një nga mrekullitë e botës



Njerëzit që në lashtësi kanë vlerësuar jo vetëm rolin ekonomik të bimëve, por edhe rolin mjedisor dhe zhukues të tyre. Kështu, kopshtet e Babilonisë janë vendosur nga njerëzimi si një nga shtatë mrekullitë e botës.

Veprimtaria ekonomike e njeriut gjithnjë e më tepër shpejton shndërrimin e mjedisit natyror në të kultivuar, forma më e lartë e të cilit është peisazhi urban.

Sot në konceptin banesës hyn jo vetëm apartamenti, vila etj., por edhe territorit që shtrihet përreth tyre.

Një filozof, përgjara që para 2000 vjetësh është shprehur: "Më jepni dy gjëra të jetë, një shtëpi plot me liba dhe një kopsht mbushur me lule dhe s'kisha për të kërkuar asgjë tjetër." Por sot, ndoshta ne nuk dimë më të kënaqemi me këto kërkesa, për të thënë se kemi aritur lurturinë.

Studime shkencore tregojnë se sipërfaqet e gjelbra janë rregullatori i përkthyer të mikroklimatit, si dhe filtri në imazh për pastrimin e ajrit nga pluhuri, gazet shëndetprishëse e kancerogjene, si dhe burimi i vetëm i pasurimit të ajrit me oksigjen dhe laboratorit në i pësosur i dyksidit të karbonit.

Por hapësirat e blerta mbartin edhe vlera të larta estetike të nëshinuar në laminin e formave të kurorave, ngjyrave të luleve, gjatave të drurëve e shkumave

dëkorative, që janë elementi bazë në kompozimin, formulimin dhe ndërtimin e hapësirave të blerta.

Tirana, e themeluar më 1616, e shpallur kryeqytet më 1920 me rreth 10 mijë banorë, në 1990 numëronte rreth 240 mijë banorë, ndërsa tani është një metropol me rreth 500 mijë, duke shtuar, sipas këtyre ritmeve drejt 1 milion banorëve deri në vitin 2020. Por me gjithë këto ritme të rritjes, ende sot e kësaj dite nuk kemi ndonjë analizë të gjendjes së gjelbërimit publik për qytetin. Me këtë rast, ose duhet pranuar se nuk janë bërë publike të dhënat, ose nuk janë përfshirë në këtë analizë shoqatat mjedisore, ose pjesëmarja e publikut kryeqytetas, që është njëkohësisht edhe taksapaguesi për sipërfaqet e gjelbra, kantetur jashtë loje.

Nga studime të kryera nga shoqata "Mjedisi, peizazhe urbane e parqe kombëtare", del se sot Tirana nga 9m<sup>2</sup> sipërfaqe e gjelbre për banor, që ka pasur para vitit 1990, ajo është muhur në masën 2,8m<sup>2</sup>/banor, gjë e cila duhet të alarmonte organet manaxhuese, kur dihet se edhe norma minimale e sanksionuar me ligj në rregulloren urbanistike për përpilimin e planeve rregulluese është pranuar 7m<sup>2</sup>/banor. Njëkohë për qytete evropiane, që quhen me parametra normale mjedisore, kjo sipërfaqe është rreth 15m<sup>2</sup> për banor.

Është alarmante dhe për të gjithë ne, kur mësojmë treguesit mjedisore të ndotjes së ajrit me shifra gati 3 deri 10

herë në shumë se parametrat e lejuara të Bashkimit Evropian.

Duhet braktisur urgjentisht mentaliteti i mbylljes nga organet manaxhuese për treguesit urban, si Bashkia e Tiranës, që asnjëherë nuk tregjet e vërteta se sa m<sup>2</sup>/banor ka sot metropoli, duke e ballafaquar atë edhe me metropole të tjera të vendve fqinje, por edhe më tej.



Është koha që duhet demouar fortë mshtrimi me fjalë në përgjithësi, se po shtohen hapësirat e blerta, mëkondë që po pakësohen. Grupim i shoqatave mjedisore "Ekolëvizja" le ta bëjë transparente gjendjen reale dhe rekomandimet përkatëse, për të shkuar drejt parametrave bashkëkohorë për hapësirat e blerta.

Për të nësuar të vërtetën, duhet bërë një klasifikim real i kësaj gjendjeje, duke zbrëthyer atë në komponentët përbërës të hapësirave të blerta është, si:

1. Lulishte m<sup>2</sup>/banor
2. Parqe m<sup>2</sup>/banor
3. Parqe periferike m<sup>2</sup>/banor
4. Gjellbërime mugore m<sup>2</sup>/banor
5. Gjellbërime ujore m<sup>2</sup>/banor
6. Gjellbërime me përdorim të kufizuar m<sup>2</sup>/banor
7. Gjellbërime muzeore m<sup>2</sup>/banor

Duke bërë këtë verifikim dhe duke ditur edhe normat e vendosura të Bashkimit Evropian, mund të analizohet dhe të zhvillohet gjelbërimi i Tiranës drejt parametrave të dhur.

Shoqata "Mjedisi, peizazhe urbane e parqe kombëtare" ka vërejtur se për hapësirat e blerta kemi një deficit kulturor, ku nga persona jo pa ndikim mbi mjedisin, planifikimin e territorit dhe bashkë

edhe hapësirat e blerta, me attribute ligjore e manaxhuese, me dashje ose me padijet e tyre, prishin ekuilibrat e ekosistemeve urbane.

Duke thënë të vërtetën, vërehet lehtësisht shkatërrimi i hapësirave të blerta për t'i kthyer ato në sheshe betoni e

asfalti. Aq e theksuar është kjo, sa edhe kur kyhet gjelbërimi mugor, në shumë raste janë zhdukur bimët e mbjella në trotuare.

Interesat e zhvillimeve urbane dhe hapësirave të blerta nuk mund të funksionojnë të copëtuara.

Nevoja për të pasur zgjidhje bashkëkohore do të kërkonte grupe profesionistësh gjithëpërfshirës (urbanistë, arkitektë, peizazhistë, ekologë, sociologë etj.), sepse vetëm kështu do të mund të hartohen plane urbane bashkëkohore dhe do të mundësohej një urbanizim me pamje evropiane.

Ing. ark. peisazhi Veiz LLUKA kryetar i shoqatës "Mjedise, peisazhe urbane e parqe kombëtare"

## Ndihmoni Syrin e Kaltër

(Vijon nga faqja 1)

vëshimit për 5 ditë mesit të përroit, në 2002, gjithë sheshi e rrëqet, përreth Syrit të Kaltër, u mbush me zhavorr në gjysmë metri lartësi. Tani ujërat e shirave dhe burimet përreth nuk rrjedhin më si dikur, sipër në sipërfaqe, por futen brenda masës së zhavorrit dhe e lëvizin atë milimetër pas milimetri drejt pikës më të ulët të sheshit që është Syri i Kaltër. Shtresa e zhavorrit ka lëvizur brenda 6 muajsh me 4 m duke e zvogëluar mjaft të beben e Syrit të Kaltër.

E gjithë kjo masë zhavorri derdhet me grykën e pjerret të syrit duke krijuar nën ujë përrenj zhavorri që depozitohen në fund të pusit duke bllokuar burimet që e kanë krijuar atë. Në 2002, kur Syri u bllokua, ujërat e tij dolën 50 m më tutje në një burim të ri mes gurëve në formën e një përroi. Edhe sot një pjesë e ujit vazhdon të dalë aty.

Lëvizja e masës së zhavorrit të gjithë sheshit po e mbush përsëri burimin me inerte. Shoqata "Nënujsat" i ka dokumentuar këto dukuri dhe bën thirrje për ta ndihmuar Syrin e Kaltër që të mos verbobet përsëri. Alami është dhënë.

Edhe pushtetarët e duan Syrin e Kaltër, por shteti ka halle më të mëdha. "Sa keq! Është bukuroshja e natyrës sonë".

Xh.Mato



# Më shumë se një intervistë



Ai po lexon diçka i ulur në sallonin e "Ekolëvizjes". Me mënyrën e lirshme dhe njëherazi të kujdesshme si mi në karrige, me gjestet e matura, me fytyrën e shëndetshme e të gjërë si një libër i hapur ku lexohet çiltërsia, dhe sidomos me heshtjen ndjellmirë që shpërndan, ai të lë vetëtimthi mbresën e njeriut të dëlirë, të pajisur me fisnikërinë e veçantë që dhuron jeta drejt e në gjirin e natyrës.

- Nga të kemi?  
- Nga Thethi, - përgjigjet ai fët-fët, i gatshëm për të komunikuar, a ke qenë në Theth?  
(i këmbëllur se kisha goditur në shenjë, gjallërdhem në çast..)  
- A vazhdon Thethi të jetë i bukur si më parë?  
- Krejt si më parë, si atëherë kur erdh' në malet tona zonjusha Durham, afër 100 vjet më parë dhe shkroi: "Kur pashë Thethin, i harrova bukuritë e tjera".  
Ai flet hijshëm, shpenguar dhe mua më duhet të tendosem për ta mprehur dialogun.  
- Kur dëgjoj emrin Theth,

gjithnjë më përfytyrohen pënenj të kristaltë malorë që pirë gjirin e dëlirës. Ujëvara të bardha që hidhen si dhi të egra nëpër shkëmbinj, ujëra të akullta në ngjyrë të kaltër e të gjelbër ku lëvizinë trofat rribi hijet e tyre të errëta që brofin nëpër gurët e lënuar nga rrjedha, aq sa të gënjenen sytë: ku është peshku dhe ku hi ja e tij..

- Krejt ashtu, lumi Kaprej që ne e quajmë Lumi i Zi, nuk turbullohet kurrë, sacb shira e stuhi të shfryjë. Po ti e ke parë filmin e Xhemal Matos për Thethin, a?

Më vjen mirë që përfytyrimet e mia për krahinën e tij dalin të sakta dhe në ngjallim e sipër i përgatit "një gradë" të vogël humoreske:

- Shiko se ju malësorët e keni të mbizhvilluar ndjenjën e hiperbolës..

- Thethi s'ka nevojë për hiperbolë. E ka falë vetë Zoti të bukur e të pasur. Kjo është një fjalë goje, sepse, të flasësh për Thethin, duhet ta shohësh vetë me sy. Por...

- Si? Edhe një bukuri kaq poetike u dësika të thyhet me porin-prozaik?

- Po, për fat të keq: është një bukuri që hup kot... që rrjedh e tretet s'di ku, që, si ta them, nuk ka sy që ta soditë, nuk ka veshë që ta ndiejë, nuk ka buzë që ta shijojë, nuk ka duar që ta prekën, si ta them..

- Mos e vrit mendjen se e

kuptova: është si ato vajzat tepër të bukura që nuk u del fati të martohen e kështu s'mund të lindin dot.

- Bash ashtu! Si zanat që mbeten pa u martue.

- Po ndoshta zanat prandaj janë të tilla, se nuk martohen.. Nejse, çfarë i ofron konkretisht Thethi turizmit malor?

- Natyrën e virgjër, me një begati të mallë mbese si askund në Shqipëri; ajrin dhe ujët e kulluar, klimën e shëndetshme (atje ke oreks më tepër se në plazh), binësinë e lamishme që ngjitet nëpër të gjitha brezat, nga shkurret poshtë e deri te bjeshkët lart në male, faunën me dhinë e egra, riqbullin, anushën, gjelmin e egër, ujkun, shqiponjën, zogjtë e pyllit. Thethi ofron ushqimin e shijshëm: djathin e ashtuqajtur të Thethit, grosh Shale, mjalte, troftën e ujërave, mishin e gjahut e të bagëtisë..

- E ç' sipërfaqe zë kjo zonë turistike?

- Parku kombëtar i Thethit përfshin 3000 ha. Tok me Dukagjinin që u shpall park kombëtar më 2004, bëhen gjithsej 30 mijë ha.

- Mos do të thuash dhe se pyjet tuaja nuk janë dëmtuar si të tjerët në verdin tonë?

- As dhe një dru, unë Dedë Nika jam inspektor i pyjeve dhe e them me përgjegjësi, asnjë dru!

- Si ka mundësi?

- Thjesht fare. Pyjet ne i kemi

ndarë sipas shtëpive, pronë private, dhe s'ka kuptim që njeriu të dëntojë vetveten. Çb i thahas e ruan pjesën e vet të pyllit nga agjentët natyrorë, se nga njeriu s'ka nevojë.

- Po ja, për të fituar, ai shatron dru nga pjesa e vet dhe e shtet. Kush e ndalon?

- E ndalon ligji dhe, më shumë se ligji, besëlidhja e malësorëve për të naujur pyjet dhe peshkun.

- Ç'është kjo besëlidhje kështu? - s'e fshih unë dot befasinë. - Kemi dëgjuar për lloj-lloj besëlidhje burrash për t'u dalë zot trojeve, porse besëlidhje për peshk e për pyje..

- Më 1 nëntor 1991 ne, malësorët e Thethit, bënë be për të mos e dëmtuar pyllin me sharrë e për të mos vzarë troftën me dinamit. Çb vit më 1 nëntor ne e festojmë këtë ditë bese.

- Cilën do të veçoje si pikën turistike më të lakmueshme?

- Ndoshta ujëvarën afër Grunasit, 120 metra të lartë.., po ndoshta dhe Pusin Pafund, ose Syrën e Kaltër të Dukagjinit..

- Si, dhe ju paskanë Sy të Kaltër? - them i habitur pa e fshetur mosbesimin. - Ama dhe ju s'bëni dot pa na kopjuar një çikë ne jugorët, - e kthej me shaka. - Mourreshim ne me Selam Musain që e zuri topin për gryke, hop dolët dhe ju me Mic Sokolin.. Si, nuk i gjetët dot një enër tjetër atij Pusi Pafund?

- E ç'faj kemi ne që turistët e huaj e quajtën ashtu, - qesh i pëmbajtur ai.

- Atëherë del që te ju ardhkan shumë turistë, gjersa arrijnë të vënë dhe emra.

- Deri në 1996 kemi pasur turizëm, sidomos në Ndërlisë ku laheshin atje tek bashkohet Lumi i Zi me Lumën e Bardhë; paskëtaj shumë pak kanë ardhur, janë shumë.

- Mos vallë i ka friguar dhe infrastruktura e dobët?

- Edhe kjo ndikon, sidomos rrugët e pashtuara. Në fakt infrastruktura ka ardhur duke u rënduar: janë kalbur urat e drunjtat rribi kanione, me ditë të tëra nuk vjen drita, qendra mjekësore pa infemier, nuk ka investime, nuk jepet kredi... Eh, ky vend gjithçka ka, vetëm nuk ka mend..

- Si nuk ka mend? - e ndërpres unë për modestinë gjithsesi të tepëruar.

- Nuk ka mend për ta vënë mendjen në punë - e kapërcen ai fare lehtë situatën. Fjala vjan, janë të gjitha kushtet për të sajuar një rezervat peshku natyror, por s'ka kush investon; për turizmin malor veç se po flitet, asgjë konkrete deri tani; fshatarët janë ende të varfër. Sidogftë dhe kështu siç është, Thethi ka me se i pret vizitorët. Vetëm të vinë një herë, se pastaj nuk do t'i ndaheshin për vit Thethit.

Bardho Dreri

## A do të vazhdojmë ta lëmë liqenin e Pogradecit në pikë të hallit?

Liqeni i Pogradecit llogaritet si një nga më të vjetrit në botë. Masha e tij llogaritet të jetë dy deri në pesë milionë vjet. Liqeni u krijua nga një shtrëbje e tokës. Këtë e vërtetojnë veçintaritet e shurta tektonike, si dhe prania e një mali prej 100 metrash në nivelin e ujit. Ai është një nga liqenet më të mëdha në gadishullin e Ballkanit dhe gjendet në një lartësi prej 65 metrash rribi nivelin e detit. Liqeni ka një sipërfaqe prej 349 km² me pikën më të thellë prej 289 m. Liqeni ndohet në kufirin ndërmjet

fumizohet me ujë nga burimet e shurta pënrreth. Një nga burimet më të mëdha gjendet përgjatë kufirit shqiptaromacedon pranë kishës së Shën Naumit. Atje buron uji që mendohet se vjen nga liqeni i Prespës, niveli i të cilit është 200 metra më i lartë se ai i liqenit të Pogradecit. Burime të tilla ka dhe brenda shtetit të liqenit. Në afërsi të Pogradecit gjendet gjithashtu një burim i madh në parkun e Drilonit, pranë fshatit të Tushemishtit. Uji largohet nga liqeni nëpërmjet të Dunit të Zi, i cili buronë

UNESKO dhe ruhet prej saj. Por abuzimet me liqenin janë rritur. Verdin emetjave industriale të dikursime tani e ka zënë mënyrja e pakontrolluar e banorëve. Proraret e lokaveve përgjatë bregut të tij, si ata që kanë leje të rregullt ndërtimi, si ata që nuk e kanë këtë leje, kanë betonuar bregun në anë të së cilit kanë rritur bizneset, nga fshati Lin deri në Tushemisht, gjatësi që shkon në rreth 35 km. Betonimet kanë kthyer në gri bregun që të shkëmbi i Lin, në Pojskë, në Piskupat, në Pogradec dhe në Tushemisht.

Por ju do pyesni veten se kush është dëmi i vërtetë që i shkaktohet liqenit?! Kjo do të thotë që liqenit të mos i lësh asnjë mundësi për t'u vetëpastruar nga ndotja e shkaktohet. Dallja në vend që t'i nxjerrë ato në breg dhe më pas të pastrohet në zall, gjen vetëm betonin. Kështu që valët kthehen përsëri në liqen me po ato mbeturina, duke shtuar rrezikun që liqeni të kthehet në kënetë.

Nuk mjaftonte vetëm kjo, pasi e betonuan bregun, njerëzit po e kthejnë liqenin në një kosh mbeturinash, e cila jo vetëm ka krijuar një pamje trenësisht të shëmtuar, por po e shkatëron atë.

Megjithë këto dëme që po shkaktohen, përsëri askush nuk i kërkoi në llogari askujt as për mbrojtjen e ujërave të liqenit, që njihen si ndër më të pastrit në Evropë. Për fat të keq, gjithçka ka mbetur në dorë të fatit.

Alma Kosova

## Zonat e mbrojtura rrezikojnë të shkatërrohen

(Vijn nga faqja 3)

Gjithashtu, është dhe projekti për liqenin e Shkodrës i cili rbaroi këtë vit dhe do të fillojë sërish vitin e ardhshëm. "Edhe projekti i Karavastës do të fillojë vitin tjetër. Edhe për zonën e Lezhës jemi në procedurat konkrete. Unë jam i mendimit që mund të bëhet më shumë për zonat e mbrojtura dhe ndërrjet ndaj tyre mund të bëhen me evidente, pasi ka ende shumë për të bërë, sidomos në nritjen e kapaciteteve të strukturave që punojnë në bazë, të njerëzve që punojnë atje", - shprehet z.Dedëj.

Sipas tij, është e domosdoshme të punohet për të krijuar një tjetër vizion, duke shtuar kontrollin e veprimtarive që kryhen brenda zonave të mbrojtura, siç janë restorantet dhe veprimtari të ndryshme fitimprurëse, të cilat mund të ndërrjnë dhe të paguajnë për mirëmbajtjen e tyre. Me këto ndërrje, në njëfarë mënyre zonat e mbrojtura do të fillojnë të mos shihen vetëm si vende ku bahet ushqim, por të kthehen në zona atraksioni natyror ku njerëzit të shkojnë atje për të vizituar këto vende, të shohin kafshët, si dhe të marrin informacionin e duhur për shunëllojshmërinë që mbartin ato. Të gjitha këto janë një pjesë e strategjisë së Ministrisë së Mjedisit, të cilat deri në tani nuk janë zbatuar ashtu siç duhet. Po sipas mendimit të specialistëve,

problemi qëndron në mentalitetin e njerëzve, pasi shumica e tyre kur shkojnë në zonat turistike, edhe pse ka plot tabela udhëzuese me informacionet përkatëse, i neglizhojnë ato dhe janë shumë larg konceptit të bukurisë që ofrojnë zonat e mbrojtura. Sipas tyre, mënyrja e vetë ministrisë në këtë zonë, nuk ka të bëjë vetëm me procesin e ndërtimit, por dhe me ndërrjegjesimin e popullatës. Në këtë pikë ministria fajëson dhe organizatat joqeveritare (IQ-të), të cilat bashkë me shtetin mund të punojnë në ndryshimin e mentalitetit të njerëzve, pasi zonat e mbrojtura te ne më shumë ndoten se vizitohen nga njerëzit. Ata theksojnë se kjo nuk ka të bëjë me investimet konkrete me fonde, por me investimet në vetë mendjen e vizitorëve. Sipas specialistit Dedëj, mënyrja konkrete e shtetit në zonat e mbrojtura, për shembull në Parkun e Dajtit, mund të qëndrojë në rripopullimin e zonës me kafshë autoktone. Por, po sipas tij, ndërrjet e vërteta konkrete kryesisht qëndrojnë tek secili prej nesh, pasi ne duhet të shkojmë në park për ta parë atë, për të shijuar bukuritë e natyrës dhe për t'i edukuar fëmijët me faktin se në natyrë jetohet mirë dhe se gjërat e bukura duhen shijuar dhe duhen vlerësuar.

E.Duraj-L. Koxhaj



dy shteteve. Pjesa më e madhe e tij i takon Maqedonisë, kurse pjesa tjetër i takon Shqipërisë. Në bregun e liqenit shtrihen tri qytete të mëdha: Ohri e Struga në Maqedoni dhe Pogradeci në Shqipëri. Gjithashtu, ai është edhe shtëpia e shumë kafshëve endemike, të cilat vijë vetëm në ujërat e tij. Ndër më të njohurat dhe ekonomiksht më të rëndësishmet është peshku i pastër i llojit Salmo letnica (kozani). Liqeni i Ohrit nuk ka një burim të veçantë. Ai

mes të qytetit të Strugës.

Por vitet e fundit po abuzohet së tepëmi me këtë pasuri natyrore që na ka dhunuar natyra. Banorët të ndryshëm kanë bërë qindra metra betonime, male me mbeturina dhe shumë gropa ku nenet rënë. Kjo është panja e një pjese të mirë të bregut të liqenit të Pogradecit, i cili është lënë prej disa kohësh në mëshirën e fatit. I njohur si një nga më të bukurit në Evropë, ai është shpallur që më 1980 monument kulture nga



# Konica- pararendësi i ambientalizmit



Asnjë bashkëkohës gjer më sot nuk e ka kapërcyer Konicën për sa i takon ndihjes dhe publikimit të asaj tërësie që qihet lota shqiptare. Qoftë kjo për nga thellësia e vërtetimit, qoftë nga spektri i gjerë (relievi, klima, gjuha, historia, prejardhja, feja, etnografia, flamuri, kostumi kombëtar, vallet, letërsia etj., etj.)

Për nga spektri enciklopedik, mendja e tij i ngjan një diament të madh me shumë prizma apo faqe. Në një nga këto faqe shkëlqen plot ngjyra të gjalla natyra shqiptare në visaret e saj të malla.

Askush para Konicës nuk e kishte lënë varësi nga thëllë tërësi e natyrës shqiptare me kukurinë dhe begatinë e paqumar, këtë lënë të virgjër të dijes së shqiptarëve. Ai e merr dhe e rimerr këtë tërësi, mezi pret të vijë rasti për t'u nënbyer nga pasioni i dashurisë të natyrës shqiptare, nga qëzimi shpirtëror për visaret që ajo derdh pa kursim me

diellin, klimën, relievin e pashog, florën, faunën, aq sa t'i ngjajë një Ciceroni që s'lodhet së shpërfaquri botës vlerat fizike dhe kulturore të një vendi të tërë turistik e muzeal. Kësisoj ai mbetet emblana e guidës shqiptare dhe ajo çka përdhën dukurinë novatore në këtë mes është vëzhgimi dhe qëndrimi për sjelljen e banorit ndaj mjedisit ku mron, sidomos ndaj florës dhe faunës. Në këtë vështrim, nuk do të teprohej po të thuhet se Faik Konica është pararendësi i ambientalizmit shqiptar.

Sot do të ishin të paktë ata shqiptarë që nuk do të ngashë-njëheshin nga etiketimi patetike e adminuese të tilla si ato të zonjës Dukan në vitet njëzet të shek.xx:

"Shqipëria është një vend i mrekullueshëm dhe tragjik. Aty ka qerë i pari altar i Zausit të "Rufesë", pse në këtë vend dimër e verë ka vetëtim dhe shira të nrepta". Duke e mirëkuptuar studiuesen e huaj, Konica nuk bie në gradën e maniakëve të figurave stilistikore. Ai konstaton se ky përshkrim: "...është mjaft i vërtetë vetëm për ca vise të Shqipërisë dhe jo për Shqipërinë përgjithësisht. Unë isha atje (Tiranë) në janar 1929 e, ndonëse malet që rrethojnë qytetin ishin të mbuluara me borë e me re, brenda në qytet trëndafilat ishin në lulëzim të plotë.. Po të më pyeste kush me dhënë, me një radhë, një mendim mbi dukjen fizike të Shqipërisë, do të thosha se karakteristika e saj më e madhe është një diversitet klimë në një sipërfaqe të vogël".

Kjo "radhë" koncize, tipike

koniciane, vjen e vërtetohet e plotësuar nga shkenohtarë gjermanë, sipas të cilëve Shqipëria rrethet e para në Evropë për sa i takon biodiversitetit për banorë.

Një karakter kaq kozmopolit, kaq nazik e njëherit kaq parafletist, që nuk ta fal optimin dhe sarkazmën, duket se ka patur shtysa tepër të fuqishme nga hijeshia e viseve antare për t'u mrekulluar nga ajo.

Le të citojmë një pasazh: "Bukuria e pashogë e maleve që rrethojnë Tiranën më mbushi me qudi... Dhe duke ndjerë në mëllqitë një erë aq të freskët sa panja që kisha para syve, rashë në mendime dhe po pyetja vetveten si është e mundur të ketë shqiptarë të lënë vendin e tyre e të venë të nojtrë në vise të luaja e të largëta në mes zhumave e tymrave të fëlliqura të fabrikave."

Konstatimet e tij, të rrikruara me citime njerëzish të mëdhenj, bashkëkohës e të lashtë, marrin herëherës ngjyresën e specialistit të gjeografisë, historisë, faunës, florës, peizazhit etj., etj.:

"Shqipëria renditet si një ndër vendet evropiane nga më të pasurat me ujëra"; "Ndërsa vetëm një pjesë e vogël e vendit është e zhveshur, pjesa e madhe është e veshur me bimësi... është e çuditshme që fauna është mjaft e varfër, me përjashtim të kafshëve të tilla si dhelpra e krahohja, dhia e egër e nbi të gjitha ariu i egër. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në të kaluarën nuk ka pasur ligje kufizuese për gjahun në Shqipëri... Po ndoshta asnjëherë nuk ka pasur me shumicë egërsira.

Varfëria e durëve të shkatëruar gjatë shekujve nga përdorimi dhe shpërdorimi në një vend ku kushdo pret dhe askush nuk mbyll dhe ku dhitë e egra e kanë dëmtuar fillizërinë.. Përkundrazi, lumenjtë, ligenet dhe deti janë të pasur me troftë, blin, shoja, gafone".

Askush nuk ka shkruar për mjedisin shqiptar sa dhe si Konica. Dhjetëra faqe, artikuj gazete, proza poetike, publicistikë, vepra letrare.Diku nëpër to ka një episod, një rënkim pas një ngazëllimi, për prerjen e një pylli të vogël "... plot me zogj, këngët e të cilëve bashkohen dhe trazohen aq bukur dhe aq ëmbël, sa duken si një simfoni e krijuar prej ndonjë muzikanti të natyrës që mron në shelgjet", i cili do të ishte preludi i asaj balade tragjike që pëson pyjet tarë këto 15 vitet e fundit.

Të njëjtën torturë padunuese përjeton ai, duke hyrë me anije në liman të Durrësit, ndërsa përgatitet të shijojë për së largu dukjen romantike të Durrësit me tetë kullat e Kthës së Mesme dhe nuk shquan as edhe një. Dhe sqaron: "Dy u prisën në kohë të luftës, (për këtë s'kanë faj shqiptarët), po tri të tjera i mëzoi dhe i fshiu një kryepalak i qytetit dhe tri të fundit që kanë mbetur janë fshesur nga dukja prej ca binave të ra që u goditën meth e motull.

Një bjanje vlerash kjo që vazhdon deri në ditët tona me plot histori "kryepalqsh" injorantë, që me një filmë mrezojnë monumente, apo ndërtesish makutë që varrosin perla mozaikësh në themelet e betonatave shumëkatëshe. Me siguri ai ka hasur

shumë skera të tilla prishëse, si, për shembull, prerja e plepave dhe zhdikja e kopshteve të Tiranës, që i thyen të gjitha autoconsurat dhe shkruan e zezë nbi të bardhë:

"Kisha aritur në Shqipëri, një vend i bekuar me një miqësi bukurie, por i shkelur nga një turmë, e cila ushqen një farë unrejtje kundër bukurisë". Këtë fshikullim kaq përcëllues ai mundohet ta zbutë në vonë, kur shkruan se "Në qoftë se në Shqipëri bukuria është e përbuzur dhe e shkëmbuar, s'ka dyshim se fisnikëria, një nga virtetet e vjetra të kombit shqiptar, është edhe e gjallë." Dhe më tej ;

"Këtu-këtej në Shqipëri mund të jenë bërë gabime kundër bukurisë, por nga ana tjetër, sa gjë e pëlqer të shohë njeriu një popull që zgjedhet dhe i vihet punës". Gjithsesi ky stigmatizim fyes mbetet dhe, sot e kësaj dite, konstatimi i panëshkrshëm dhe idhnik konician e ndan me dysh opinionin e komunitetit tonë, çka u pa dhe gjatë fushatës "Jeto gjelbër", vetëm një javë më parë.

Poqujt ndryshojnë tepër ngadalë, me shekuj dhe mijëvjeçarë, dhe omet e kombit tonë, midis tyre edhe mëkati i lartpërmendur, janë po ato të këshës së Konicës, ('97-ta e vërtetoi këtë katërcipërisht ). Atëherë me duhet të pozicionohemi qartë: Ta njohim sëmundjen tonë, ta pranojmë dhe ta luftojmë, apo të mos e pranojmë për shkak të "namazit"? Mesazhi që na dërgon Konica është: Njih vlerat e tua, ji i vetëdijshëm për to, por mundu "të diagnostikosh" edhe antivlerat për t'i luftuar ato.

Kastriot Mahilaj

# E keqja e vogël dhe e keqja e madhe

-Vazhdon odiseja e ndotjes së ujit të pijshëm dhe të mjedisit në Bogovë dhe në malin e Tomorit

Pelegrinët që këtë gisht do të bëjnë kubanin e tyre në teqenë e Baba Aliut, duke u ngjitur përpjetë Tomorit, ndryshe nga viti i kaluar, do të vënë re më shumë livadhe e shpate mali të prishura, por më pak ose aspak kamionë me pillaka të verdha guri ngarkuar që zbresin tatëpjetën e thepisur, të mbushur dirkas. Shirat që kanë rënë këtu fundimiri mbi shpatin verior të Tomorit të shenjtë, mrezuan edhe atë "mal" indiferentizmi që kishte mbretëruar i qetë për më se një gjysmëshekujve.

As interesi i medias apo i ndonjë specialisti të izoluar (drejtori i ujësjellësit F.Shehu e vuri alamin që para tre vjetësh) nuk kishte aritur të zgjonte përgjegjësit e dëmtuar lokalë e qendrorë. U desh që Tomori i plagosur të mrejdhë lllum në rubinetet tanë, dhej me dëmos që thika të futej thellë që të reagtej.

Policët seriozë e të vendosur që mirë atje ku muga për në Bargullas e Nvaj lë murgë racionale, aritën të malin entozgjirë.

"Pas disa javësh ndërprerje të gëmimeve,- shprehet për "Lajmëtarin" drejtori i ujësjellësit,- rezultatet dëken qartë. Edhe pse reshjet kanë vijuar me një intensitet të madh, turbullimi i ujit këtu kohë të fundit , ka qerë pothuajse inekzistent".

Por me ndërprerjen e nxjerrjes së gurit, nuk duket se beteja ka mbatur. Ka mbatur vetëm raundi i parë. Tani ndodhemi në pushimin ndërmjet raundeve.

Prefekti pret analizat e detajuara nga specialistët tiranas që në vonë t'i japin drejtim zgjidhjes së problemit.

Firmat dhe masa e madhe e puntoreve që presin sa vjen e më shumë shqetesohen, tregtarët që eksportojnë shtinin se malli që ishte i depozituar në sheshet që shtrihen gjatë gjithë murgës nga Beati deri në Bogovë, po mbaron.

"Në do t'i mbyllim që para dy vjetësh,- thotë Ercin Baçe. - Prefekti i asaj kohe përdori edhe dhunën policore, por u sqarësua para koston së lartë sociale. Rreth 2 000 veta humbasin vendet e punës. Por tani mjaft më, - vijon deputeti socialist,- nuk e kuptoj se ç'pret më ministri. Edhe ushtrinë të përdorë për të vendosur në karantinë zonën. Firmat shumë mirë mund të pajisen me leje në një zonë tjetër ku s'prisnin malin e s'motin burime".

Frika se mos kësaj here e kanë seriozist, duket lehtë në fytyrat e policanëve që punojnë nëpër gurorë.

Në Poliçan pas mbylljes së uzinës së amëve, nxjerrja e gurëve dekorativë u dha sërish oksigjen ekonomive të varfira familjare, dikush përdorte edhe fuoristradën për të sjellë pillakat nga mali. Lindën edhe shumë biznese që eksportin pillakat në Itali e Greqi (ato në të mëdatë janë nga Beati ), për nxjerrjen e të cilave impenjohen jo vetëm punëtorë të zonës afër, por deri dhe nga Korça e largët.

Atje ku ishte gjuma e Baba Aliut tani të lë pa fjale "një qytet" qorakash plasmasi e deri me ndonjë kioskë, nga ato që zaptimin sheshet e qyteteve të vërteta deri para disa vitesh.

"Qyteti" përshkohet në mes nga një murgë ku kamionët fuoristrada me tri akse aktive ngjiten e zbresin

shpatit të thepisur të Tomorit.

Ekonomitë e tjera në zonë pothuajse nuk ekzistojnë, vetëm në Bogovë e afërt, kohët e fundit biznesi i turizmit ka bërë të lindin një sërë restorantesh që me murgë e rehabilituar kanë shanse të mira zhvillimi.

"Do bënin mirë ta mbyllin,- shprehet një pronar lokal i buzë murgës nacionale, kur e pyeta si do të ishte më mirë për ata,- këtu njerëzit



vinë për ujin e malin, nëse ata prisin, edhe ne mbyllim."

"Mjedisi është ekonomi, më thotë specialisti i ngjitur i mjedisit Xhmal Mato në një intervistë,- fitimet nga mjedisi janë të shunta. Në këtë rast fitimet janë të sipejta se askush nuk paguan taksën e mjedisit, ndaj edhe ndjellin interesin e aq shumë njerëzve".

Nuk ka murgë, plane zhvillimi për këtë zonë dhe njerëzit e zonës asnjëherë nuk e dinë sa fitojnë e sa humbasin. Pasi ajo që fitohet aq

shpejt, ka edhe kosto shumë të madhe mjedisi, që mund të çojë në braktisjen e detyruar të vendit, atë që ne e quajmë migrim mjedisor.

"Mbyllja e kësaj veprimtarie u heq banorëve të zonës të vetmen mundësi jetë",- i them.

"Sigurisht nuk është e lehtë,- vijon,- pjesa më e madhe e banorëve duhet t'i hedhë sytë tjetërkund. Nuk mund të jetohet vetëm me gurë. Nga përvoja jonë ne kemi parë se zonat që

falimentojnë. Por edhe me policë nuk mund të mbyllet. Duhet që të studion plane zhvillimi për të gjithë zonën. Shfrytëzimi mund të bëhet sa 1/10 e asaj që është tani. Ja shihë këtë nishanin,- dhe më tregon një që ka në mjekër,- edhe ky është turor, por nuk përhapet e s'oheton organet e tjera jetësore të trupit, pasi është i izoluar e i kontrolluar. E rëndësishme është, që banorët e zonës të informohen mirë e me trasparenëse se cilat janë të mirat e të këqijat. Shqiptarët kur informohen mirë, kanë kuptuar, shifim rastin e TEC-it të Vlorës vetëm pasi u informuan kuptuan se ç' ishte në mirë për ta.

Raundi i dytë po afrohet pasi "ampushimi" s'do të zgjasë gjatë shumë.

Sicë që të jetë vendimi që do të marrë prefekti, do të ketë reagime.

Nga njëra anë banorët e Beratit s'do "ta gëlltisnin" kollaj një ujë që vazhdon të turbullohet (e shtrënjtchet), ashtu si edhe banorët e zonës së Poliçanit do ta kenë të vështirë të pranojnë një vendim që i nxjerr sërish në murgë si 10 vjet më parë.

Mos Historia përsëritet? Banorët e zonës më shumë se 10 vjet më parë, para faktit të mbylljes së uzinës dblan në murgë e i krijuan probleme shtetit. Rrethanat nuk janë më të njëjtat, mbështetja që atëherë jepte qozitja, duket se këtë herë mungon. Perspektiva e 110 000 banorëve pa ujë i trenb më shumë se 10 000 banorëve pa buke..

Një fjale e urte thotë se jo çdo e keqe vjen për të bërë dëm. Turbullimi i Bogovës duket se do të shpëtojë Tomarin nga turori që po i përhapet.



## Ciklistë nudo nëpër qytetet spanjolle dhe meksikane

Qindra ciklistë nudo më 10 qershor kaluan rreth qyteteve spanjolle të shtunën për të protestuar kundër rrugëve të mbushura me makina dhe kërkuan respekt më të madh për transportin pa rrëtye.

Me slogane si: "Një makinë më pak" dhe "Bicicletat", në shpinat

tij. Nërsa, Barcelona ka më shumë rrugë për biçikleta ndër të gjithë qytetet spanjolle.

Pronësia e makinave për frymë në Spanjë u rrit pas rritjes së madhe ekonomike.

Po këtë ditë dhjetëra ciklistë kaluan të zhveshur për mes qytetit të Meksikës, duke kërkuar respekt



e tyre, ciklistët e zhveshur zhvilluan ciklin e tretë të përvitshëm për Spanjën, "Ciclonudista", në Madrid, Barcelonë dhe Pamplona.

Protesta ishte pjesë e evenimenteve të shtegtitimit të zhveshur mbi biçikleta të së shtunës në Evropë, Amerikën e Veriut dhe të Jugut. Organizatorët thanë se ciklizmi është një formë e shëndetshme dhe e frytshme e transportit urban, që injorohet jashtë mase nga shoferët spanjollë dhe projektuesit e qytetit.

Qendra e Madridit ka shumë pak rrugë për biçikleta dhe ciklistët janë të mallë në rrugët e

nga motoristët dhe duke protestuar ndaj kulturës së orientimit drejt makinave në këtë qytet gjigand.

Me slogane si: "Respektimi ata që ngasin biçikletat", të shkuar në trupat e tyre, ciklistët e zhveshur tërhoqën vëmendjen në një qytet ku madje është e mallë të shohësh njerëz të veshur që ngasin biçikleta nëpër trafikun kaotik. "Kjo është ajo që na duhet të bëjmë që shoferët të na shohin dhe të na respektojnë", - tha njëri prej tyre. Demonstruesit e së shtunës, gjithashtu theksuan se ata po ndihmonin në zgjidhjen e problemit të strogut për qytetin.

## Pyjet dhe ndryshimet klimatike

Menaxhimi më i mirë i pyjeve luan një rol kyç në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ndryshimet klimatike dhe pyjet janë të lidhura ngushtë. Në njërin anë, ndryshimet në klimën globale janë pothuajse duke i stresuar pyjet nëpërmjet temperaturave mesatare vjetore më të larta, të ndërthurura me sistemin e reshjeve dhe shumë dukuri atmosferike të vazhdueshme dhe ekstreme. Në të njëjtën kohë, pyjet dhe drurët që ato prodhojnë, thithin dhe depozitojnë dioksidin e karbonit, duke luajtur një rol të madh në lehtësimin e ndryshimeve klimatike. Dhe në anën e mbrapme të monedhës, kur shkatërrohen ose shfrytëzohen tej mase dhe digjen, pyjet mund të bëhen burim i gazit të efektit serë, dioksidit të karbonit.

FAO ka paralajmëruar se tani duhen ndërmarrë veprime për të menaxhuar këtë marrëdhënie komplekse në mënyrë më të përgjegjshme.

"Ne duhet të ndalojmë shpyllëzimin dhe të shtojmë zonën e mbuluar nga pyje", - tha Wulf Killmann, që drejton departamentin e ndryshimeve klimatike të FAO-s.

"Por, ne gjithashtu duhet të zëvendësojmë lëndët djegëse fosile me lëndë djegëse biologjike, siç janë lëndët e drurit nga pyjet e menaxhuara me përgjegjshmëri, në mënyrë që të zvogëlojmë emetimet e karbonit dhe duhet të përdorim më shumë dru në prodhimet me jetëgjatësi të madhe që të mbajnë "të mbrerthyer" karbonin larg atmosferës për periudha në të gjata koha.

Si kapin pyjet një trilion ton karbon?

Kur lëndët djegëse fosile digjen çlirojnë dioksid karboni në atmosferë, duke kontribuar në rritjen e dioksidit të karbonit atmosferik, që në vazhdim ndikon në ngridjen globale dhe ndryshimet klimatike.


Por, edhe pyjet ndihmojnë në lehtësimin e këtyre ndryshimeve duke larguar dioksidin e karbonit nga atmosfera dhe duke e shndërruar atë gjatë fotosintezës në karbon, të cilin më pas e "depozitojnë" në formë druri dhe vegjetacioni, një proces që quhet "sekustrim i karbonit".

Në përgjithësi pemët pëmbajnë 20 % karbon në peshën e tyre, dhe përveç vetë pemëve, biomasa e përgjithshme e pyjeve gjithashtu shërben si një "kosh karboni". Për shembull, lëndë organike në tokat pyjore, siç është humusi i prodhuar nga dekompozimi i pjesëve të thara

të bimëve, gjithashtu shërben si një depozitë karboni.

Si rezultat, pyjet depozitojnë sasi të mëdha karboni. E marrë në mënyrë të përgjithshme, pyjet dhe tokat pyjore të të gjithë botës aktualisht

Veçanërisht në tropik, ku bimësia rritet me shpejtësi dhe si pasojë e largon karbonin nga atmosfera më shpejt, mbijellja e pemëve mund të largojë sasi të mëdha karboni nga atmosfera



depozitojnë më shumë se një trilion ton karbon, që është dy herë më e madhe se sasia që qarkullon e lirë në atmosferë, sipas studimeve të FAO-s. Shkatërimi i pyjeve, nga ana tjetër, shton rreth gjatë bilionë ton dioksid karboni në atmosferë çdo vit, dhe parandalimi i "anatisjes" së karbonit të depozituar është i rëndësishëm për bilancin e karbonit dhe jetik në ruajtjen e mjedisit.

Pyjet mund të përdoren më mirë për të luftuar ndryshimet klimatike!

Kjo mund të arrihet jo vetëm duke parandaluar prerjen e pyjeve, por edhe nëpërmjet pyllëzimeve (mbijelljeve të reja) dhe ripyllëzimeve (rimbijellja e zoneve të shpyllëzuara) të tokave të papjellëzuara.

brenda një kohe relativisht të shkurtër. Këtu, pyjet mund të depozitojnë rreth 15 tonë për hektarë në vit karbon në biomasën dhe drurin e tyre.

FOA dhe ekspertët e tjerë kanë vlerësuar se zvogëlimi i karbonit global nga pakësimi i shpyllëzimeve ka rritur mbarehtësinë e pyjeve dhe shumë pyje dhe plantacione mund të kompensojnë rreth 15% të emetimeve të karbonit nga lëndët djegëse fosile gjatë 50 viteve të ardhshme.

Në të vërtetë, nëse menaxhoen siç duhet, pyjet mund të furnizojnë me bioenergjia pothuajse pa kontribuar me ndonjë gaz të efektit serë në atmosferë.

## Përmbledhje e studimit të ri për biokarburantet

Biokarburant është një tem i përgjithshëm për çdo karburant të lëngshëm që prodhohet nga burime të tjera nga rezervat minerale, siç janë: nafta, qymyri dhe gasi. Në përgjithësi biokarburantet mund të përdoren si një zëvendësues ose shtesë për benzinën dhe naftën në shumë përdorime në transport ose jo. Biokarburantet që përdoren më shumë zakonisht janë biodieseli dhe bioetanol.

Etanoli dhe biodieseli mund të pakësojnë dukshëm varësinë



globale nga nafta, sipas një raporti të institutit "Worldwatch", të publikuar në bashkëpunim me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Teknik (GIZ) dhe Burimet e Përtëritshme (FNR). "Biokarburantet për transportin: mundësi globale dhe ndërlikime për një bujqësi dhe energji të qëndrueshme në shekullin e 21-të", e

sponsorizuar nga Ministria Gjermane e Ushqimit, Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, është një vlerësim i hollësishëm i mundësive dhe rreziqeve që shoqërojnë shkallën e madhe të përhapjes ndërkombëtare të biokarburanteve.

Vitinekaluar, prodhimi botëror i biokarburanteve e tejkaloi sasinë prej 670 mijë fuçi në ditë, që është ekuivalente me rreth 1% të tregut botëror të karburanteve për transport. Megjithatë nafta ende llogaritet të zërë më shumë se 96% të përdorimit të karburanteve për transport, prodhimi i biokarburanteve është dyfishuar që në 2001-shin dhe është ekuilibruar madje edhe për rritje më të mëdha, ndërkohë që industria reagon ndaj çmimeve më të larta të karbu-

ranteve dhe politikave mbështetëse të qeverisë. "Aksioni i




koordinuar për të zhvilluar tregjet e biokarburanteve dhe avancuar

teknologji të reja mund të zbusë



ndërkohë që fuqizon ekonominë bujqësore dhe redukton emetimet

që shkaktojnë ndryshimet klimatike", - tha presidenti i



institutit "Worldwatch", Christopher Flavin.

Përktheu materialet: Rovena Tashi



## Shkurt nga bota

### PYJET DHE DEPOZITIMI I KARBONIT

Duri i prerë shërben si një "kosh karboni". Duri i përdorur për ndërtim ose mobilie e depoziton karbonin në mënyrë efektive për shekuj. Materialet e ndërtimit me energji të lartë që përdoren në vend të drurit, siç janë



plastikat, alumini ose çimentoja, kërkojnë sasi të mëdha lëndësh djegëse fosile gjatë përpunimit. Si rrjedhojë, zëvendësimi i tyre me lëndë drusore ka përfitimë shtesë përpara i përkjet reduktimit të emetimeve të karbonit.

Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i lëndës djegëse drusore në vend të naftës, qymyrit dhe gazit natyror, aktualisht mund të zbusë ndryshimet klimatike. Duke qenë se djegia e drurit dhe biomasës çliron diksid karboni në ajër, nëse këto lëndë djegëse vijnë nga pyje të shfrytëzuara në mënyrë të qëndrueshme, ky karbon i çliruar mund të kompensohet nëpërmjet mbjelljeve të reja.

### KAPJA E KAFSHËVE TË MËDHA ËSHTË NJË BIZNES I MADH NË AFRIKËN E JUGUT

Kapja e kafshëve është një biznes serioz në Afrikën e Jugut dhe është kthyer në një tregti të mirë për vendet e rrethta. Pothuajse unike në të gjithë botën, jeta dhe shumimi i kafshëve të gjuetisë së Afrikës së Jugut ka qenë një industri në rritje, ndërsa ka shenja të një rënies të qumëve për shkak të sigurimit të një sasive të madhe kafshësh.

Kafshët mbahen për një sërë qëllimesh, për mbarështrim, për gjueti dhe për shitje në rezervate të tjera gjuetie. Ato kapen si në prona shtetërore ashtu edhe private.

Çdo vit largohen rreth 3500-4500 kafshë gjuetie. Paratë e fituara përdoren për rritjen e fondëve të fshatrave pranë dhe për mbarëvajtjen e parkut. Kjo po bëhet e rëndësishme për komunitetin.

Puna kërkon precizion, që nga kohëzgjatja deri tek dozat e përdorura. Shumë mund të gabojnë, pasi kafshë të ndryshme trajtohen në mënyra të ndryshme. Mund të përdorësh qetësuesin ose dozën e gabuar dhe ta ngordhësh kafshën. Këto operacione kërkojnë kohë, pajisje dhe shpenzime.

Sidoqndërsa, kostoja e lartë dhe rreziqet theksojnë natyrën fitimprurëse të këtij biznesi.

## GRUPIMI "EKOLËVIZJA"

- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Shkodër - Fatbardh Sokoli
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Tiranë - Pranvera Bekteshi
- Shoqata Kribojtare progresi pyjor - Tiranë, Liljana Shehu
- Albaforest, Tiranë, Mehmet Meta
- Qendra Eden, Tiranë - Merita Mansaku
- Klubi Ekologjik, Krujë - Miharrem Goci
- Shoqata e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror, Berat - Genta Decolli
- Liliun Albanicum, Librazhd - Ferit Hysa
- Masmedia dhe Mjedisit - Xhemal Mato
- Qendra për Komunikimin Elektronik, Tiranë - Ladi Balla
- Qendra Kribojtare e Lëvizjes Ambientaliste, Tiranë - Haziz Marku
- Klubi Ekologjik, Elbasan - Ahmet Mehmeti
- Instituti i Studimeve të Ambientit, Tiranë - Agron Deliu
- Laguna e Kaltër, Oricum - Skënder Mejdiaj
- Klubi Ekologjik, Librazhd - Naim Disani
- Shoqata Pylli i Bleritë - Buçimas, Pogradec - Ruzhdi Hymetllari
- Milieukontakt Oost Europa, Tiranë - Valbona Mazreku
- Shoqata e Përmakulturës, Tiranë - Edlira Mulla
- Klubi Ekologjik, Tiranë - Fatos Xhemalaj
- G&G Group, Tiranë - Sazan Guri
- AULEDA, Vlorë - Hasan Hallko
- Shoqata Mjedisit Ekologjik dhe Turistik Lura, Lurë - Ismail Hysa
- Shoqata kribojtare e gjuetarëve dhe peshkatarëve sportivë të Shqipërisë, Tiranë - Themë Peni
- Qendra e konsulentëve veterinarë dhe sigurisë ushqimore, Tiranë - Gani Moka
- Klubi Ekologjik, Maliq - Myzafer Gjirriti
- Shoqata "Natyra për njeriun", Durrës - Fali Ndreka

Përktheu materialet: Rovena Tashi

## Shkurt nga bota

### ZANAFILLA: 1972, KONFERENCA E STOKHOLMIT MBI MJEDISIN NJERËZOR

Bazat për qeverisjen mjedisore botërore u hodhën në Konferencën e Stokholmit mbi Mjedisin njerëzor në vitin 1972. Ky ishte forumi i parë ndërkombëtar që iu drejtua sfidave botërore të mjedisit. Konferenca u fokusua mbi ndotjen rajonale dhe problemet e shiut acid në Evropën veriore. Grupi i të 77-ve dhe bilokut lindor kundërshtuan, pasi ata e shihnin këtë si një eko-program. I ndjekur nga 113 vende, forumi theksoi nevojën për një pikëpamje të përbashkët dhe fillime të përbashkëta për të nditur dhe drejtuar njerëzit e të gjithë botës drejt ruajtjes dhe përmirësimit të mjedisit njerëzor. Konferenca u zhvillua në institucionin e United Nations Environment Programme (UNEP).

### EMETIMET E GAZEVE SERË NË KANADA JANË LARG OBJEKTIVAVE.

Otavë: Emetimet e gazeve serë në Kanada janë tani 35% më tepër se niveli që u premtua të arrihej mbas marrëveshjes së Kiotos për ndryshimet klimatike dhe shteti duhet të ndalojë çdo tren, aeroplan apo makinë që të arrijë qëllimin e tij, tha ministrja e mjedisit Roma Ambrose.

Ambrose tha se Kanadaja nuk ka shanse për të arritur objektivat e protokollit të Kiotos që, gjatë periudhës 2008-



2012, të zvogëlojë emetimet deri në 6% më pak se niveli i tyre në vitin 1990. Ky qëllim është pranuar nga qeveria liberale e mëparshme.

"Mbas kësaj jave ne do të publikojnë inventarin e gazeve serë në Kanada dhe ai do të tregojë se niveli i emetimeve tani është 35% më i lartë se objektivat e Kiotos të vendosura nga liberalët", - tha ajo në parlament.

"Për ta vendosur këtë në perspektivë, do të thotë që sot ne duhet të largojmë nga rrugët e Kanadës çdo tren, aeroplan dhe automobil. Kjo nuk është e realizueshme.

të dhënat në të fundit treguan se emetimet në Kanada po arrijnë 24,4% mbi nivelet e vitit 1990. Kjo do të vazhdojë të rritet për sa kohë që platformat e naftës vazhdojnë të përhapen gjithnjë e më shumë në pjesën perëndimore të pasur me energji të provincës së Albert-ës.

Burimi: Reuters

## Shkurt nga bota

### Job Vacancy announcement

EDEN Center (Environmental center for Development, Education and Networking) is considering to employ an experienced individual to work in a job that blends the coordination tasks of Capacity building projects of EDEN center.

Even this is a part time position, this person should all the time acts as an ambassador for the EDEN center and its activities.

#### Responsibilities:

- § Prepare the work plans and coordinate the Capacity building projects of EDEN center
- § Prepare training modules and provide the available information to the trainers group
- § Organise training and other events in accordance with the Center 's work plan
- § Assist in preparation of educative materials
- § Assist in in the development of information and education activities
- § Work with Center 's Director in preparing proposals and narrative reports for the programs run by the Center .

#### Qualification and skills:

- Experience in Project coordination and implementation
- Good Knowledge on basic computer programs
- Good knowledge of English language
- Strong writing and communication skills
- Strong organizational skills and attention to details
- Committed to work with environmental issues
- Able to work under time pressure

#### Personal competence:

- Ready to work independently and pro-active person
- Ready to take responsibility, result driven
- Ability to work in team and in an international context
- Ability to travel out of duty station

If you are interested and of course match the above-mentioned profile, it would be our please to receive your applications.

Please send a letter of motivation, and the CV, Diploma until June 21, 2006 to

EDEN Center, Rr. Avdyll Frasheri, ish klinika e Udhëheqës, shk 3, ap. 4.

Tel/Fax: 4 234851

e-mail: eden@mail.com or eden@eden-alb.org

Please consider that only selected candidates in short list will be announced

### Të nderuar nxënës, mësues, prindër!

Qendra "EDEN" dhe Bashkia e Tiranës ju ftojnë të merri pjesë edhe ju në fushatën për ndarjen dhe riciklimin e letrës.

Le të punojnë të gjithë së bashku për të pasur një mjedis më të pastër dhe më të shëndetshëm.



### Botimi i "Ekolëvizjes" mbështetet nga fondacioni "Princ Bernhard Cultuurfonds"



Adresa e redaksisë: Ish- klinika qeveritare, shkalla 3, kati IV, Tiranë  
Tel.: 04 234 851, Cel.: 068 21 82081 e-mail: ekolevizja@yahoo.com

TIRAZHI: 600 KOPJE

STAFI

EDITORI - Xhemal MATO  
Kryeredaktor - Kastriot MAHILAJ  
REDAKTORE  
Ornela SHOSHI  
Rovena TASHI